



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 53 prot.

Kamëz, më 11.042023

V E N D I M

Nr. 41, datë 11/04 2023

M B I

Dhënie e Ndhmës Financiare për Djegie Banese

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 11.04.2023, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.29 Datë 11.04.2023 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile, VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.202, datë 10.03.2023, për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesë, relacionit të hartuar nga administrata e Bashkisë, në zbatim të urdhërit, dhe V.K.B-së Nr. 163, datë 21.12.2022 "Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2023, 2024 dhe 2025, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606, Këshilli Bashkiak Kamëz,

V E N D O S I :

1. Miratimin e kërkesës së Drejtorisë Emergjencave Civile dhe Strehimit për mbështetje financiare të familjes së: z. [REDACTED], për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 05.03.2023.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko – ligjorë hartuar në formën e kriterëve në relacion, sipas preventivave të komisionit të vlerësimit të dëmeve hartuar nga administrata e Bashkisë Kamëz, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë "Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmtimeve të shkaktuar në banesën e z. [REDACTED]".
3. Të akordohet një ndihmë financiare për këtë familje sipas tabelës më poshtë:

Nr	Emër Atësi Mbiemër	Vlera e dëmit lekë	Për pagesë 50% e vlerës në lekë sipas VKM-së nr. 329, dt. 16.05.2012
1	[REDACTED]	185,739	92,869
	TOTALI	185,739	92,869



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

4. Ndihma financiare për familjen e dëmtuar përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.
5. Kjo shumë prej 92,869 (nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

